

SHMEK “8 Shtatori” Revista “EKONOMISTI”



Tetovë, Mars 2021

7 Marsi Dita e Mësuesit



7 Marsi është Dita e Mësuesit, është dita që na përkujton kur u hap mësonjëtorja e parë në gjuhën shqipe në Korçë nën drejtimin e Pandeli Sotirit pikërisht më 7 Mars 1887, prandaj kjo ditë çdoherë na kujton mësuesit tanë. Shkolla e parë shqipe ishte me karakter kombëtar e laik (jo fetar) ku të gjitha mësimet jepeshin në gjuhën shqipe. Drejtues të shkollës ishin figura të njohura të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, si: Pandeli Sotiri, Petro Nini Luarasi, Nuçi Naçi, Thoma Avrami etj. 7 Marsi është festë kombëtare dhe jo vetëm për punojnësit e arsimit shqiptar por edhe për nxënësit e studentët.

Kur kujtojmë këtë ditë nuk mund të lëm pas as rolin e mësuesëve që dhanë kontribut të madh e as të prindërve që luajtën një rol po aq të rëndësishëm në zhvillimin e arsimit shqip.

Kjo ditë po ashtu përkujtohet si një ngjarje me rëndësi kulturore e historice, konsiderohet edhe si një fitore shumë e madhe për popullin shqiptar sepse para hapjes së shkollës së parë mësuesit shqiptarë mësimet i mbanin nëpër shtëpi private dhe fshehurazi shkak se ishin nën sundimin osman, duke rezikuar edhe jetën e tyre vetëm që ti arsimit nxënësit gjë që duhet vlerësuar tej mase. Për të arritur deri te dita që të hapet shkolla e parë ,janë bërë shumë përpjekje e janë tejkalluar shumë rreziqe të mëdha .Çdo vit festohet 7 Marsi ,gjë që neve na bën të kujtojmë që sa sakrificat kanë bërë mësuesit e parë që ne tani lirshëm të mësojmë gjuhën tonë të dashur, gjuhën shqipe. Populli shqiptarë që më heret,që para shumë vitesh ka qenë i rrethuar me luftra, të gjithë armiqtë kanë pasur të njëjtin qëllim ,që gjuha shqipe të mos shkruhet e flitet,që shqiptarët të zhduken ,e të asgjësohen ,që më vonë të mos figurojnë si komb. Kjo ishte “motoja” apo qëllimi kryesor që të na zhdukin nga faqja e dheut. Sot jemi krenarë që jemi shqiptarë ,asnjëherë nuk e kemi mohuar përkatësinë tonë kombëtare edhe pse na kanë vrarë e na kanë prerë ,por gjithsesi zëri jonë gjithmonë ka bërë titur fortë e është ndër.

“JEMI SHQIPTARË ORE, JEMI SHQIPTARË!” ...

Edhe sot ne i kujtojmë me respekt të gjithë ata që sakrifkuan veten që ne sot të kemi shkolla ku të arsimohemi, te flasim gjuhën tonë si dhe te shkruajmë me shkronjat tona shqipe që janë me të bukurat. Sot i gjithë kombi shqiptarë ka me mijëra shkolla, arsimtarë, univerzitet, doktorë e për gjithë këtë merita i kushtohet te parëve tanë që nuk kursyen as veten e tyre, dhanë jetën e tyre për lirinë e vendit tonë, dhanë jetën që ne sot të gëzojmë të drejtën për tu shkolluar në gjuhën amtare, prandaj asnjëhere nuk duhet harruar mudi dhe sakrificat e tyre.

Mësuesit shqiptarë janë ata që në kohërat më të vështira për kombin tonë na mësuan qëllimet e rrugëve tona, ata janë dhe do të jenë faqja më e ndritur e historisë së popullit shqiptarë. Mësuesit shqiptarë jo vetëm që ishin mësimdhënës por në radhë të parë ishin edhe patriot.

Nuk kanë thënë kot: “Mësuesi i mirë është si një qiri. Ai konsumon vetveten për t’u ndricuar rrugën të tjerë”



8 Marsi Dita Ndërkombëtare e Gruas

8 Marsi llogaritet si Dita Ndërkombëtare e Gruas. Kjo ditë kishte për qëllim të ndihmoj kombet në mbarë botën të eliminojnë diskriminimin ndaj grave gjithashtu u përqendrua në ndihmën e grave për të marrë pjesëmarrje të plotë dhe të barabartë në zhvillim global. Të jesh femër në ditët e sotme konsiderohet si fatbardhësi kurse në kohët më të hershme ishte vetëm një fatkeqësi. Pse ishte një fatkeqësi të lindësh një femër në kohën e hershme? Si në vendet e tjera ashtu edhe në vendin tonë femrën e mbanin si robëreshë femra nuk kishte asnjë të drejtë, por lind pyetja se kush ishte shkakuar i kësaj? Kultura dominante e mashkullit ishte mjaft e fuqishme një ndër shkaqet kryesore të kufizimit të të drejtës së gruas.



Babai i shiste vajzat e tij kudo që të dëshironte mund t'i jepte hua por edhe mund dhe ti mbyste e shumë tjera gjëja të këtij lloji. Kështu pra femra nuk kishte asnjë të drejtë si qenie njerëzore, edhe para burrit të saj nuk kishte asnjë të drejtë të bënte ndonjë vizitë, të dilte për pazar ose ndonjë gjë tjetër ishte e mbyllur çdo ditë në shtëpi të laj e të fshij, të përgatit bukën për burrin e saj e të kujdeset për kafshët, atë e mbanin pronë ashtu siç i mbanin skllëverit. Pra, gruaja nuk kishte qetësi në shpirt e as të drejta si tek babai i saj ashtu edhe tek burri. Për këtë shkak gratë u çuan në këmbë më 28 shkurt të vitit 1909 ku një grup aktivistesh kryesisht gra por edhe disa burra u mbledhën në New York për të diskutuar për të drejtat e grave dhe për ti dhënë fund kësaj fatkeqsie që u ndodhte femrave dhe më 8 Mars ja arritën qëllimit të tyre dhe prej atëherë 8 Marsi çdo vit shënon ditën kur femrat ngritën zërin për të drejtat e tyre, dhe çdo ditë e më shumë nisi të rritej imazhi i femrës, barabarësia gjinore filloi të luaj një rol të madh në shoqëri.



Siç e tham dhe më parë të lindësh një femër në ditët e sotme konsiderohet si fatbardhësi, femrat i kanë të gjitha të drejtat e barabarta me të meshkujve, kanë të drejtën e shkollimit, punës nëpër institucione si në spital, politikë, arsim, gjykatë etj, pra ku kanë të drejtë meshkrujt kanë e dhe femrat. Sot më nuk janë një sekret apo fshehtësi krimet nga më mizoret që ishin bërë ndaj femrave gjatë historisë.

Mirjeta Durmishi III-7

JETA E FEMRËS SHQIPTARE

Të gjithë jemi të vetdijsëm për dhimbjen e vazhdueshme që ka duruar femra shqiptare ndër vite. Nga shtypja dhe injorimi zyrtar tek ai shtëpiak, shoqëror por edhe tek ai bashkëshortor. Vështirësite me të cilat është ballafaquar femra shqiptare, sidomos në të kaluarën nuk mund të përshkruhet dot me fjalë, janë munduar shkrimtarët të shprehin me anë të librave, përmes shkrimeve, aktorët përmes filmave të shumtë por asgjë nuk është e mjaftueshme që të tregoj se çfarë



krijese e shenjtë është femra. Përgjatë shekujve, ka qenë e ndaluar që një vajzë e rëndomtë sidomos nga fshati, të shkollohet, ka qenë turp që një vajzë të kryej shkollën fillore e ku me shkollën e lartë, e kanë parë si diçka të pamundshme, e kanë trajtuar këtë çështje si një ndalesë të rreptë përshkak të mentalitetit të prapambetur të popullit tonë që e ka formuar idenë se vajzat duhet të qendrojnë në shtëpi dhe të jenë shërbyese të të gjithë anëtarëve të familjes, të durojë maltretime, dhunë dhe ofendime në heshtje. Poshtërsia e mos të qenurit të arsimuar ka mundësuar që, në atë kohë, të mos ketë asnjë farë lloji force ose ditorie që një grua të arrijë të ngrihet në këmbë kundër diskriminimit që i bëhet. Por me kalimin e viteve për fat të mirë me anë të emancipimit dhe modernizimit të popullit tonë, nga mërgimi në vende tjera dhe nga hapja e syve ndaj një jete demokratike dhe moderne femrat e popullit tonë kanë aritur që pak nga pak të arsimohen dhe të shkollohen. Fal ligjeve të shumta që e bënë të detyruar arsimimin e ulët dhe të mesëm në vendin tonë, tani në ditët e sotme të gjitha të rejtat shqiptare janë duke u arsimuar.



gjërat nuk kanë dryshuar plotësisht por as edhe mjaftueshëm përshkak se vazhdimisht ndodh po e njëjta shtypje dhe tallje si në kohët e më parshme, por diferenca është se femrat kanë prioritetizuar veten dhe të ardhmen e tyre, gjë e cila nuk lejon që ofendimet e të tjerëve t'i ndalojnë ato. Na gëzon fakti se sot kemi femra shqiptare të suksesshme në të gjitha sferat dhe veprimtaritë e jetës si në shëndetësi, arsim, politikë, culture, gazetari, sport etj, dhe dita ditës zëri i femrës po bëhet sa më l fuqishëm.

Madhështia letrare e dy figurave të ndritura nga Tetova

Murat Isaku dhe Abdylazis Islami

Murat Isaku dhe Abdylazis Islami janë dy figurat qendrore në fushë të letërsisë që bëjnë të njohur emrin e Tetovës sonë. Figura këto që me përkushtimin e vet letrar e kombëtar arritën që të kujtohen ndër popullin tonë si meritoret e veçantë që zëri i shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut të dëgjohet brenda territorit ku jetonin e deri në Shqipëri e më gjërë. Padiskutim që kushtete dhe rrethanat politike e historike ndikuan në formimin e tyre si shkrimtarë dhe njëkohësisht me këtë edhe si zëngritës të çështjeve problematike me të cilat ballafaqoheshin bashkëkombasit e tyre. Madhështia e tyre qëndron në atë vetëdije, sa që gjithçka që shkruajnë e thonë, si edhe të gjitha veprimet që kryejnë orientojnë nga interesat e mëdha kombëtare.

Kjo më mirë vërehet në veprimtaritë e tyre letrare ku shprehin dashurinë e zjarrtë për vendlindjen, çështjen kombëtare dhe popullin që jeton në to. Ato luftojnë kështu për një atdhe të emancipuar, ku secili individ ka dinjitetin dhe të drejtat e veta, ka lirinë e tij, ka të drejtën natyrore dhe legjitime të jetë i barabartë me të tjerët, ta ruajë e ta zhvillojë më tej gjithçka të vetën, origjinale, atë që është lindur e gjendet që në "rrënjët e shpirtit" të popullit të vet.

Që të dy këto figura të rëndësishme për popullin tonë, edhe Murat Isaku edhe Abdylazis Islami lindën në fshatin Gajre të Tetovës. Murat Isaku në vitin 1928, ndërsa Abdylazis Islami në vitin 1930. 2005 e kanë vit të përbashkët të largimit të tyre nga kjo jetë.

Për dallim nga Abdylazis Islami që deri në përfundim të studimeve qëndroi në Maqedoninë e Veriut, Murat Isaku përgjatë rrugëtimit të shkollimit bëri lëvizje nga një shtet fqinj në tjetrin, Kosovë, Shqipëri, Sërbi. Që të dy pas mbarimit të studimeve punuan në punë të ngjashme ose të përafërta që kishin të bëjnë me profesionin e tyre, punuan si: mësues e profesorë të gjuhës shqipe, redaktorë e gazetarë.

Ajo që lidh përjetësisht shpirtërat e tyre dhe njëkohësisht madhëron figurat e tyre është pasioni i tyre për letërsinë. Do të përmendim disa vepra të veçuara nga këta dy shkrimtarë.

Nga Murat Isaku:

"Zani i malit" (1960)

"Buzëqeshjet e mesditës" (1963)

"Dielli e din rrugën e vet" (1965)

"Gërsheti" (1978)

"Blana" (1982)

"Flaka e vonar" (1973)

"Plagët" (1975)

"Etje" (1982)

"Fatprerët" (1995)

"Shtjella" (1989)

Nga Abdylazis Islami:

"Këngët e zgjuara" (1968)

"Soditje nga toka" (1969)

"Oaza" (1973)

"Ujrat" (1976)

"Për qepallat e qiellit varen plepat" (1983)

"Përtej Kohës" (2005)

"Fatiana" (1975)

"Dredhia" (1996)

"Dritë në sfond" (1980)

"Përralla popullore nga Sharri" (1985)

“Libri është gjethi që nuk bie kurrë nga pema”

Kurr kemi ardhur në këtë botë, të gjithë kemi patur një kapacitet të njëjtë. Njeriu ka ushqyer mendjen e tij sipas dëshirës. Një njeri që e ka ushqyer mendjen e tij me libra, dijeni, hulumtim, ëndrra, shpresa, ai është fara e frytit më të ëmbël të pranverës. Ndërsa ata njerëz që humbin jetën e tyre nga krenaria, mendjemadhësia, paraja, droga, janë thjeshtë si ato pemët në fund të vjeshtës të mbetura pa asnjë gjeth.

Në këtë botë të gjithë kemi paragjykime të shumta ndaj njëri-tjetrit sidomos nga pamja, por, një fjalë e urtë popullore thotë: “Edhe një milingonë e vogël mund të rrëzoj një pemë shumëshekullore”. Jo për të gjithë ekziston fjala *jetë*, shumë njerëz ditët i kalojnë me një maskë, ku shpesh ndodhë që pas një buzqeshjeje të fshihet një dhimbje e madhe. Vjen ajo *nata* që simbolizon dhimbjet, vetminë dhe shiritin e shkëputur të shpresës, aq yje sa ka në qiell, aq dhimbje ka shpirti i njeriut, por një moment mes gjithë atyre yjeve bukuria më e madhe është Hëna.

Tek njerzit bukuria më e madhe është *shpirti*. Plotësoni atë me gjëra të bukura, plotësoni atë duke lexuar libra. Mjafton të plotësoni dhe ta mbushni jetën tuaj me gjërat që doni dhe padyshim që jeta juaj do të jetë e bukur e do t’i ngjasoj pemës së mbushur me gjethe dhe mbi të gjitha pemës së frytshme.

Njerëz harroni të shkuarën jetoni me shpresë se pranvera e vitit tjetër do të vij më e bukur për ty. Do jetë e frytshme vetëm me veprat tua. Kujdesu për to.

SI KA NDIKUAR SITUATA ME PANDEMINË (COVID 19) NË JETËN TONË

Po bëhet një vit prej kur edhe në vendin tonë si në të gjithë botën u paraqit pandemia COVID 19, e si pasoj e kësaj të gjithëve na ndryshoi jeta. Pikërisht më 11 mars bëhet 1 vjet që kur u mbyllen edhe shkollat sikur edhe shumë biznese e veprimtari të tjera, ndërsa në vend u shpall edhe gjendje e jashtëzakonshme për një periudhë, pas së cilës pasoi edhe karantina, dmth përnjëherë mund të themi se të gjithëve na u ndryshua ritmi i jetës.

Edhe pse kjo periudhë e jashtëzakonshme mbaroi gjithashtu dhe karantina, ne ende vazhdojmë të jetojmë me pandeminë në mesin tonë, me frikën dhe rrezikun nga pasojat e saj.

Në këtë periudhë pandemie nuk kemi edhe aq mundësi për të bërë edhe shumë gjëra, mendoj që këtë periudhë gati se të gjithë njerëzit i bëjnë aktivitetet e njëjta si prsh:

Për të ikur nga realiteti dhe për tu qetësuar nga “zhurma” që po krijojnë mediat lexojmë libra, për të qetësuar veten dhe për të rikujtuar gjitha momentet e kaluara degjojmë muzikë, për t’i buzëqeshur këtyre ditëve shikojmë filma, përveç këtyre kemi piktorët të cilët në tablot e tyre paraqesin botën e ëndrrave ,dhe në këtë periudhë kemi mundësinë për të mësuar edhe shumë gjëra të reja për të cilat më parë thonim që s’kemi kohë .

ÇKA NDIKUI POZITIVISHT DHE NEGATIVISHT NË KËTË PERIUDHË?

Ana pozitive e këtyre ditëve është se kemi kaluar më shumë kohë me familjen , kemi pasur më shumë kohë të merremi me veten , të largohemi nga zhurma e jetës ,të kuptojmë se të gjithë jemi të njëjtë dhe nuk na dallon asgjë , të merremi me aktivitete që koha dhe teknologjia ua kishin vendosur një shtresë pluhuri, rigjenerimi i tokës.

Ana negative e kësaj gjendjeje është se njerëzit po hyjnë në një gjendje stresi, gjithashtu është dhimbshme edhe rritja e numrit të madh të të vdekurve dhe të infektuarve në vend dhe në botë, mos gjetja e një kure ,rrënja e ekonomisë, të varfër të cilat nuk kanë mundësi t’i përmbushin nevojat kryesore , rritja e çmimeve të produkteve kryesore ,mbyllja e të gjitha institucioneve (ngecja e bizneseve, shkollave, punëve etj). Gjendja momentale është mjaft stresuese dhe tragjike në të njëjtën kohë. Ata që e bëjnë stresuese këtë periudhë janë mediat por edhe populli, shteti duke u munduar të na tregojë seriozitetin e gjendjes në të cilën ndodhemi detyrohet që nëpërmes mediave një masë të popullsisë ta vetëdisojë. Ajo që e bën tragjike këtë periudhë është pamundësia për ta ndaluar shpejtesinë e përhapjes së virusit. Por ajo që e bën me serioze dhe tragjike gjendjen është se po luftojmë me një armik të padukshëm.





Sipas mendimit tim kjo gjendje është mjaft e rëndë për psikikën e njeriut e cila mendoj që do të lërë pasoja edhe pas kësaj gjendjeje. Ajo që e bën këtë gjendje më të vështirë është edhe venitja e shpresës, duke parë se si dita e ditës humbim më të dashurit tanë pa mos pasur mundësi të bëjmë dicka dhe tu ndihmojmë. Kjo gjendje ka ndikuar në menyë negative për psikikën tonë, por e cila na ka bërë të kuptojmë se shëndeti është mbi të gjitha. Njerëzit gjithashtu ndjehen si të mbyllur në kafaz, pa mundësia për tu takuar me të afërmit, pa mundësia për ta kontrolluar virusin, dhe të gjitha këto kriojnë një luftë në psikologjinë e njeriut.

Mbetemi me shpresë se kjo gjendje në cilën ndodhet e gjithë bota jo vetëm vendi jonë do të kaloj shpejt dhe te mbetet në të kaluarën, si një e kaluar e hidhur e dhimbshme sidomos për njerëzit që gjatë kësaj periudhe humbën njerëzit më të dashur të tyre, dhe sa më shpejt t'i kthehemi jetës normale.

LIDERSHIPI I FEMRËS TË FITOSH PUSHTET



Lidershipi paraqet proces në të cilin individi ndikon te grupi i individëve në arritjen e qëllimit të përbashkët. Sot gjithnjë e më shumë rritet numri i femrave që përfshihen në biznese të ndryshme dhe arrijnë suksese. Kur bëhet fjalë për biznes, femrat kanë treguar se dinë të drejtojnë njësoj ose me mirë se meshkujt. Femrat po fitojnë fuqi që mund të sjell një perspektivë ndryshe në vendimmarrje. Të jesh femër e suksesshme do të thotë të kesh vetëbesim, qëndrueshmëri, pasion dhe ambicie si forcë që shtynë në pozicione drejtuese.

Lidershipi i femrës është kthyer të jetë një fakt i epokës moderne i shfaqur si një fenomen i

natyrshëm në të gjitha nivelet, ai ka sjell tipare që kanë tërhequr vëmendje te të gjithë.

Femrat i karakterizon imagjinata dhe intuita, vendosshmëria dhe vullneti për të çuar deri fund. Ata janë të kujdesshme që në çdo angazhim te mos harrojnë detaje dhe hollësi që shpesh merrnin shumë vlerë. Femrat i pranojnë gabimet dhe nga ata nxiten që të punojnë e të bëjnë shumë përpjekje për të ndryshuar.

Po sjellim disa emra nga femrat më të suksesshme lidere:

- Kylie Jenner, e cila u bë e famshme dhe e suksesshme me prodhime kozmetike. Ku pasuria e saj në fillimet e saj është rritur drejt deri në 900 milionë dollarë. Jenner ia ka kaluar edhe Marck Zuckerberg. Është një nga femrat që arriti sukses të madh në një moshë shumë të re 21 vjeçe dhe është milionerja më e madhe për moshën që ka.

-Sheikha Mozah, pasuria e saj është vlerësuar në 10 miliard dollarë, është gruaja e dytë e Emirit të Katarit dhe nënë e shtatë fëmijëve. Krahas asaj që është edhe një aktiviste sociale dhe politike, ajo gjithashtu lobon për avancim në shkencë dhe teknologji në vendin e saj. Është shpërblyer me doktorata të shumta nderi dhe e quajnë zonja e parë e mbuluar më elegante në botë.

-Pansy Ho, pasuria e saj është vlerësuar në 3,4 miliard dollarë. Ajo është e bija Stanley Ho, i njohur si “mbreti i kazinove”. Nga 14 fëmijët, Pansy është më e pasura në familjen Ho në saje të shpirtit të saj sipërmarrës dhe themelimit të një numri kompanish. Sot ajo ka më shumë para se babai i saj.

Nga këto pak emra që i përmendëm krahas shumë tjrave që kanë bërë emër në nëper botë fale punës dhe angazhimit të tyre, lirisht mund të themi se femrat mund të jenë sipërmarrëse dhe udhëheqëse shumë të suksesshme në sfera të ndryshme të jetës si: shkencë, arsim, politikë, kulturë etj.

A ekziston shoqëri e sinqertë mes të rinjve?

Unë mendoj se te shoqëritë e vërteta ka sinqeritet dhe jo gjëra dashakeqe apo tendecioze, madje tek ndonjë shoqëri është sinqiriteti më i fortë, por te ndonjë shoqëri nuk ekziston fare sinqeriteti, këto shoqëri shpesh ballafaqohen me bullizëm.

Te shoqëritë e sinqerta fitohet edhe një besim shumë i mirë. Ka plot miqësi që zgjasin deri në pleqëri. Shpesh herë meshkujt mendojnë se femrat nuk janë të forta, mund të tallen me ta, por unë mendoj se kjo lloj shoqërie nuk duhet të ekzistoj aspak, sepse edhe femrat me mundin e tyre mund të arrijnë shumë lart.

Shoqëritë e sinqerta na duhen të gjithve sepse ne mund të mësojmë, festojmë, bëjmë bashkëpunime të ndryshme me ta, ato do t'i kemi pranë në ditë të mira dhe ditë jo të mira. Te miqësitë ku nuk ka sinqeritet, pastërti dhe besim, shpesh bëhen bashkë djem dhe vajza, me dashje apo qoftë rastësisht, dhe në këto raste futet dikush në mes, një palë e tretë, e cila ndikon që ato në mes vete të krijojnë përçarje dhe me këtë rast japin përshtypje të keqe te të tjerët dhe si pasojë e kësaj njerëzit e tjerë nuk shoqërohen me ta, ju thonë fjalë rënduese, vetëm nga ajo që nuk besojnë më në shoqëri të vërteta dhe të pastra. Unë shpresoj se këto shoqëri një ditë do ta kuptojnë se çfarë gabimi kanë bërë. Çdo vajzë dhe çdo djalë duhet që të kenë te drejtat e barabarta, t'i respektojnë mendimet e tyre.



Dhe kështu duhet të vazhdojë shoqëria e mirë deri në fund.

Të përgjegjshëm ndaj të vërtetës

Sikur të pranojmë çdo gjë që na thuhet nga njerëzit dhe të ndikohemi çdo herë nga fjalët e tyre është jo normale, përkundrazi duhet të mësojmë nga fjalët apo nga mendimet e njerëzve. Shpesh ndodh që na thuhet fjalë të rënda por a duhet thënë të gjitha të vërtetat dhe deri ku? A mund të pranohen të vërtetat ashtu siç janë dhe kur janë të shëmtuara dhe a ja vlen të thuhet të gjitha sit ë tilla? Po të shprehim të gjitha të vërtetat që nga mëngjesi nuk do e kalonim jetën aq lehtë nga presioni i fjaleve. Është e vështirë të kalosh jetën duke u bërë pre e tyre. Po sikur njeri të çohet në mëngjes i lodhur nga puna që ka bërë deri vonë ndoshta mund të jetë i sëmurë, takon një mik e i thotë: " po çke që je shëmtuar kaq shumë, po çke që ke humbur?", kurse ai në të vërtetë po mundohet të punojë për një jetë më të mirë. Por ky është njeriu që po thotë të

vërtetën, atë që po sheh por është njeri që me të vërtetën nuk ka një raport përgjegjshmërie.

Njeriu i cili është i përgjegjshëm pasi shikon që tek ti ka ndryshuar diçka për keq në fakt të thotë "mos të ka mërziur gjë" në një mënyrë e të shprehurit të së vërtetës krejt tjetër në mënyrë që të kuptosh që ai e di që të ka ndodhur diçka jo e mire, dhe jo nuk je shëmtuar diçka mund të të ketë ndodhur si mund të të ndihmoj? Nuk është që je shëmtuar ose të ecin gjërat keq. Për mua ka rëndësi që përball teje të jap atë për-



jetim që jam këtu për ty sepse ti nuk je mirë sot apo je i lodhur nga puna. Kjo ka lidhje me të vërtetën? Po! Por më shumë ka lidhje me përgjegjshmërinë ndaj të vërtetës dhe realiteti që na rrethon.

Po ashtu këta janë njerëzit që mbajnë peshën e botës mbi shpatulla, mbi krye. Këta janë njerëzit që shohin keq dhe të thonë nuk është aq keq sepse ata do ta marrin përgjegjsinë. Këta janë njerëzit që të kuptojnë që ti nuk je në te mirën tënde dhe nuk të thonë o Zot sa keq nuk ta thonë sepse e din që do bëhesh edhe më keq dhe kush ta thotë do që të të bej edhe me keq.

Këta janë njerëzit që përtypen dhe në një moment të caktuar e mbajnë për vete dhe kërkojnë të të perçojnë ty vetëm atë që të ben mirë ty. Mirëpo çfarë ndodh pastaj? Ndodh një herë, ndodh tre herë, dhe nuk e marrin mbrapsht, shpesh ndodh që nuk e marrin mbrapsht ku-jdesin që ata tregojnë tek tjerët. Dikush e merr si teori xhepi dhe po pati lek është i mirë ky. E kthejnë koken ka ndonjëri i cili edhe i ka sharë përkundrazi vrapojnë nga ai që i ka share që ta bindin se nuk janë ashtu. Një mekanizëm komplet faji që nëse dyqind njerëz të duan shumë por një i vetëm të shan ai duhet ndjekur nga mbrapa, dhe ti thuash që ti nuk je ashtu, pavarësisht se ti po i le pas njerëz tjerë vet, që nuk të kanë sharë, që nuk kanë mendim të keq për ty. Pse? Sepse shumica e edukimit shqiptar dhe kjo është një e vërtetë faktike lidhet me kompleksin e fajit. Na kanë edukuar që nëse diçka ndodh gjeje tek vetja dhe Jo ta gjejm tek faktet.

Efektet e pandemisë në ekonomi

Virusi Korona në mënyrë dramatike e ndryshoi jetën në vendin tonë. Tërë ajo që e dinim si normale në jetën publike, në interaksionin social dhe komunikim, tani është në test. Si asnjëherë me parë. Bota po e përjeton krziën më të madhe pas Luftës së Dytë Botërore. Virusi Korona shumë shpejt i tejkaloi kufijtë kombëtar dhe tani shumica e shteteve dhe banorëve të planetit ballafaqohen me pasoja fatale dhe të vështira për shëndetin e tyre. Kjo situatë na ballafaqoi të gjithëve me shumë pyetje dhe brengë.

U ndërmorëm masa shumë serioze dhe drastike. Disa prej tyre, siç janë vendosja e gjendjes së jashtëzakonshme dhe kufizimet e lëvizjes, ishin rezultat i vendimeve të vështira por të pashmangshme.

Nga pandemia shumica e sektorëve kanë pësuar humbje ku më së shumti objektet hotelerike por ka pasur edhe sektore që nga fillimi i pandemisë ata kanë shënuar rritje. Në Maqedoninë e Veriut është kryer një studim mbi efektet e shkaktuara nga COVID-19 në sektorin



e turizmit dhe hotelierisë me rekomandime për trajtimin e efektve ekonomike. Hulumtimi u krye nga Oda Ekonomike e Maqedonisë. Duke krahasuar shtetet tjera shteti jonë ka ndihmuar shumë pak ose mund të themi edhe fare si personat fizik ashtu edhe ndërmarrjet sidomos objektet hotelerike të cilët kanë qenë më të prekurit në këtë aspekt shteti jonë ata i ka ndihmuar shumë pak ku është dashur që të gjitha humbjet ti mbuloj që të mos shkojnë në falimentim për shkak se me falimentim do rritet papunësia edhe do të krijohet një krizë që do jetë e vështirë për të rikthetur aty ku kemi qenë. Megjithatë kemi pasur rritje edhe në sektorin e tregtisë elektronike. Përderisa shumica e sektorëve në ekonomi po kalojnë humbje dhe po luftojnë për të mbijetuar shkaku i krizës së shkaktuar nga koronavirusi, Maqedonia e Veriut ka shënuar rritje të tregtisë elektronike. Analiza e Shoqatës për Tregti Elektronike tregon se qytetarët e Maqedonisë së Veriut në tre muajt e parë të këtij viti në tregtinë elektronike kanë shpenzuar gjithsej 28,9 milionë euro dhe vetëm në muajin mars 10,1 milionë euro. Kjo paraqet një rritje prej 17,9 milionë eurosh (61,5 për qind) në krahasim me periudhën e tre muajve të parë të vitit 2019. Të dhënat tregojnë se tregtia elektronike në mars të këtij viti u rrit me 99 për qind në krahasim me marsin e vitit të kaluar.

NDËRMARRJET E VOGLA, TË MESME DHE TË MËDHA

Ndërmarrja është një organizatë e cila harmonizon fuqinë punëtore, kapitalin real, teknikën, informacionin dhe diturinë për të prodhuar produkte dhe shërbime. Ndërmarrjet mund t'i ndajmë në: ndërmarrje të vogla, të mesme dhe të mëdha. Ndërmarrjet e vogla kryejnë shërbime për një numër të caktuar të shfrytëzuesve dhe prodhojnë sasi të vogla të prodhimeve, këto ndërmarrje duhet të kenë maksimum 50 të punësuar dhe në numër të konsiderueshëm përfaqësohen në strukturën e përgjithshme të ndërmarrjeve në çdo ekonomi tregëtare. Në vendin tonë, ekziston një numër i madh i ndërmarrjeve të vogla, të cilat kryejnë veprimtari të ndryshme. Përparësitë e ndërmarrjes së vogël janë: fleksibiliteti, pasioni, qëndrueshmëria, pavarësia, kontributi lokal, shumëllojshmëria dhe kontakti me klientët, gjithashtu ka edhe disa mangësi të cilët janë: përgjegjësitë e pakufizuara, kushtimi i kohës vështirësitë në menaxhim, resurset e kufizuara financiare.

Ndërmarrjet e mesme karakterizohen me vëllim të madh, me numër më të madh të punëtorëve deri 250 punëtorë. Shërbimi financiar zakonisht i kryen punët, në fushën e punës së pagave, arka etj.

Ndërmarrjet e mëdha në mënyrë të ndërsjelltë bashkëpunojnë dhe plotësohen në procesin e prodhimit, në bashkëpunim janë ndërmarrjet të cilat përbëhen prej një numri të madh të ndërmarrjeve të vogla dhe ndërmarrjeve të mëdha që janë të lidhura me interesat e përbashkëta. Ndërmarrjet e mëdha duhet të kenë mbi 250 të punësuar.

Në vendin tonë ka shumë ndërmarrje të mëdha, por ne do ta veçojmë ndërmarrjen Ecolog e cila ka realizuar mbi 1100 projekte dhe është aktive në më shumë se 36 vende, duke llogaritur edhe 12000 punëtorë, ofruesi kryesor i zinxhirit të furnizimit, ndërtimit, teknologjisë, menaxhimit të objekteve dhe shërbimeve mjedisore.



Gjithashtu vendit tonë i duhet një ndërmarrje e cila do merret me vendosjen dhe menaxhimin e metrove, që vendit tonë i duhen shumë sepse vendosja e tyre e bën jetën tonë më të sigurt dhe më të mirë, si dhe do të ndodhin më pak aksidente dhe jeta jonë do të jetë më e sigurtë.

Korrupsioni dhe zhvillimi i tij

Korrupsioni është dukuri shumë dimensionale po aq i vjetër sa dhe vet njerëzimi. Korrupsioni është në natyrën e vetë njeriut që mundohet të krijoj privilegje dhe përfitime personale pa marrë parasysh nevojat e të tjerëve ai gjendet në të gjitha mjediset në të gjitha sistemet e mundshme duke bërë një kërcënim për ato.



Korrupsioni në vendin tonë është i përhapur dukshëm në shoqërinë tonë, shpitalet, bizneset, në familje, institucione shtetërore etj.

Korrupsioni nënkupton shkelje të ligjeve dhe dallimet mes njerzëve të pasur dhe të njerzëve mesatar që në shumë raste shkelet e drejta e tyre.

Në ditet e sotme po thuj se çdo i dyti njeri korruptohet për arsye personale të dikujt. Siç e dim të gjithë fjala korrupsion vjen nga gjuha latine corrumpere' thyej ose shkatërroj. Pra akti korruptiv shkatërron ose thyen ligjin, detyrat dhe normat morale.

Korrupsionin nuk mund ta ndalojmë dot por ne duhet të mundohemi që mos korruptohemi dhe mos jemi pjesë e një korruptimi të dikujt.



Mendimi Kritik

Mendimi kritik përfshin një mori aftësish komplekse që lidhen në një nivel më të lartë të të menduarit. Është një mendim i pavarur që sjell ide të reja për zgjedhjen e problemeve. Kjo nënkupton reflektimin në mënyrë kritike për përvojat e proceseve të nxënësit, dhe marrjen e vendimeve efektive duke shmangur pengesat e zakonshme, sipër shembull vënien në dyshim të dëshmive që nuk përputhen me idetë tuaja.

Zgjidhja e problemeve është proces mendor që përfshin aftësinë për të analizuar dhe për të gjetur zgjidhjen më të mirë për problemin. Ajo përshkruan procesin kur një qëllim pengohet për ndonjë arsye, si mungesa e burimeve etj. Ka problem të zakonshme dhe të pazakonshme. Problemet e zakonshme mund të zgjidhen duke përdorur metoda që nxënësit i njohin dhe duke i përdorur hap pas hapi metodat e mësuara më parë. Problemet e pazakonshme janë problem për të cilat nuk ka qasje ose mënyrë të përdorur më parë, të aplikuara me sukses ose të sugjeruar me detyra.



SI TRAJTOHEN NË MESIN TONË PERSONAT ME SINDROMËN DOWN?



Sindroma Down nuk klasifikohet si sëmundje por si një çrregullim kromozomik ku nga 46 kromozonet që janë normale personat me sindromën Down kanë 47 kromozome.

Për shkak se nuk është sëmundje nuk ka edhe shërim për të, statistikat e dhëna nga organizata botërore e shëndetit konstaton se nga 1,000 deri 1,100 e foshnje që lindin në bote kanë prej tyre posedojnë sindromën Down.

Fëmijët e lindur me këtë sindromë kanë ngecje zhvillimore dhe disa karakteristika fizike të pamjes së jashtme por edhe me këto vonesa zhvillimore ata mundën ta mbërrijnë kapacitetin e tyre me mbështetje nga ambienti i tyre ku ata jetojnë dhe me një përkrahje nga njerëzit ata mundën t'i zbulojnë talentet dhe aftësitë e tyre.

Gjithashtu në botë ka një numër të konsiderueshëm të njerëzve me këtë sindromë që janë të suksesshem siç janë: aktori dhe këngëtar amerikan Chris Burke, aktori Britanik Tommy Jessop, aktori Spanjoll Pablo Pineda që gjithashtu është edhe evropiani i parë me sindromën Down që ka kryer arsimin e lartë univerzitar.

Këta persona të lartpërmendur na tregojnë se edhe të prekurit me këtë sindromë mund të arrijnë të kenë një jetë normale dhe të lumtur ashtu edhe siç jetojmë ne të tjerët dhe nuk duhet t'i llogarisim si të huaj por t'i inkuadrojmë në aktivitete të përditshme socio-kulturore që edhe ata ta kenë mundësinë që të socializohen në komunitet dhe ne të solidarizohemi me ta sepse edhe specialistët



dhe ekspertët kanë konstatuar se edukimi arsimor i të prekurve me sindromën Down do të ishte më efikas nëse zhvillohet me bashkëmoshatarët e tyre.

Sindromës Down i është kushtuar që nga vitet e 80-ta muaji tetor si një muaj për tu njohur me mundësitë dhe mbërritjet e personave me sindromën Down dhe për tu festuar ajo se ata janë ndryshe sepse sot në këtë botë duhet shumë kurajo për të qenë ndryshe.

“Njerëzit me sindromën Down mund të bëjnë çdo gjë- me të vërtetë çdo gjë!”

-Brittany Schiavone

“Kromozoni 21- një bekim i fshehtë.

TUBERKULOZI



Tuberkulozi është një sëmundje infektive ngjitëse e shkaktuar nga mykobakteri tubercular, në të kaluarën në gjuhën e përditshme njihet me emrin “verem”. Tuberkulozi sulmon mushkëritë, por mund të shfaqet edhe në organet tjera të trupit në gjëndrat limfatike, në kocka, në organet e urinimit, dhe ato gjenitale, në sistemin nervor, në lëkurë dhe në shumë organe tjera. Kryesisht sëmundja shfaqet tek personat që kanë imunitet të dobët, kushte të vështira të jetesës, si dhe kequshqyerja shihet si faktorët që kanë rikthyer rastet e sëmundjes së tuberkulozit.

Kjo sëmundje kërkon marrjen e rregullt të mjekimit dhe kontakte të shpeshta me mjekun, parandalimi dhe kontrolli i tuberkulozit kryesisht mbështetet në vaksinim, në vendin tonë që prej vitit 1994 bëhet vaksinimi i të porsalindurve me vaksinën e tuberkulozit.

Është e rëndësishme që njeriu gjatë gjithë jetës së tij të ketë ushqyerje të shumëllojshme me proteina, vitamina e kripëra minerale, karbohidrate dhe yndyra për të siguruar një imunitet të fortë të organizimit, edhe kushtet e jetesës duhet të jenë të mira dhe me standart. Duke qenë se tuberkulozi është një sëmundje infektive me shkallë të lartë kontagioziteti (ngjitëse) merr rëndësi të veçantë kërkimi i rasteve të fshehura në vende të grumbulluara publike siç janë shkollat, kopshtet, repartet ushtarake e të tjera.

Njeriu mund të preket nga tuberkulozi kur ai është në të njëjtin ambient me personin e sëmurë nga tuberkulozi. Rrezikun më të madh të marrjes të sëmundjes e kanë ata që jetojnë në të njëjtën familje, dhe ata njerëz që janë shumë pranë ose kanë kontakte të shpeshta me të sëmurin.

Tuberkulozi nuk përhapet nga të gjithë ata që janë të sëmurë prej tij, ai përhapet nga ata njerëz që janë të sëmurë nga tuberkulozi i rrugëve të frymëmarrjes, dhe përhapet kur kolliten, teshtinë ose edhe kur flasin duke lëshuar bakterie në ajër.

Këngëtarët Alban Skenderaj dhe Miriam Cani një çift shumë i preferuar nga publiku



Kam disa preferenca të këngëtarëve dhe një ndër ato është edhe Alban Skenderaj me bashkëshorten e tij Miriam Cani, janë një çift shumë i preferuar nga publiku.

Alban Skenderaj është autor këngësh dhe këngëtar shumë i njohur.

Ka lindur në Lushnjë me 20 prill të vitit 1982, mirëpo me origjinë është nga Vlora.

Babai i tij në atë kohë punonte si oficer dhe i duhej të shpërngulej në Lushnjë ku dhe lindi Albani. Pas disa vitesh ai u kthye prapë në Vlorë, Albani atje kreu shkollën e mesme "Halim Xhelo".

Ai atje vazhdoi në një shkollë për Hoteleri-Turizëm, mirëpo këtë degë ai e la sepse që te bënte karrierë atij i duhej te lëvizte shumë. Më vonë ai hapi një biznes të vogël bashkë me vëllezërit e tij.

Ai bashkë me një shok u largua drejt Italisë me një anije të rastit, ndërkohë që familjet e tyre nuk dinin asgjë.

Ai atje vazhdoi në një shkollë për Hoteleri-Turizëm, mirëpo këtë degë ai e la sepse që te bënte karrierë atij i duhej te lëvizte shumë. Më vonë ai hapi një biznes të vogël bashkë me vëllezërit e tij.

Në të njëjtën kohë, ai punonte dhe si infermier terapist pasi kishte bërë një kurs për këtë zana. Ndërkohe, ai kishte bërë dhe një kurs disa mujor për kitare dhe për kanto. Në Itali, ai merrte shpesh pjesë në konkurse të vogla që zhvilloheshin në qytetin ku jetonte, ku fitonte shpesh çmime. Ndonëse larg Shqipërisë ai i ndiqte aktivitetet muzikore që zhvilloheshin atje. Në dhjetor të 2004 ai provoi të merrte pjesë në festivalin e RTSH-s, por nuk u pranua. Mirëpo tani ai është një nga këngëtarët më të dëgjuar dhe më të njohur në vend dhe është i martuar me këngëtares poashtu shumë te dashur për publikun shqiptarë Miriam Cani.

Miriam Cani lindi me 30 Maj të vitit 1985 ne Elbasan te Shqiperisë. Eshtë njëra ndër më të preferuarat e mia prej artisteve shqiptare. Eshtë këngëtare shumë e njohur dhe gjithashtu shumë e dashur nga publiku.

Skena është shtëpia e saj e dytë dhe Miriam Cani është sprovuar me të që në moshë të vogël kur nisi kurset e para të këndimit, kërcimit dhe pianos. E angazhuar në shfaqje teatrale dhe aktivitete të ndryshme muzikore, ajo hodhi hapat e parë drejt një rrugëtimi që një ditë do t'i dhuronte adhurues të panumërt.

Kur ishte vetëm 5 vjeç ajo u shpërngul për në Gjermani së bashku me prindërit dhe vëllain e saj. Përveç shkollës, Miriam mori mësim për kanto dhe kërcim, luante teatër, u përfaqësua në shumë klube sportive dhe që në fëmijëri skenën e kishte si shtëpinë e saj. Pasioni i Miriamit që në fëmijëri të hershme ka qenë gjithmonë muzika.

Nga mosha 14 vjeçare, për tre vite rresht ajo mori rregullisht mësim për piano dhe kanto. Karriera e mirefilltë e Miriam Canit nis në Gjermani, në vitin 2003, kur zgjidhet si pjesëtare e grupit të muzikës pop “Preluders”.

Për publikun shqiptar, Miriam Cani u bë e njohur masivisht me këngën “Let me die with you”, dueti i parë me Alban Skënderaj, partnerin e saj. Duke pasuar me suksesin e këngës së parë solo “Mos më ndal”, e që nga ajo kohë Cani nuk është ndalur kurrë. Karriera e saj vazhdon të konsolidohet si në Shqipëri ashtu dhe jashtë saj.

Ajo njihet me këngëtarin Alban Skenderaj nga mesi i viteve 2000 dhe sot janë një nga çiftet më të dashura shqiptare. Jetojnë të lumtur në Tiranë dhe kanë dy fëmije vajzën Amelie dhe djalin Duam.



Fjalë të urta

Dobësia e sjelljes bëhet dobësi e karakterit (Albert Einstein)

Dikush mund të buzëqesh dhe të jetë djall (William Shakespeare)

Nëse s'mund të fluturosh, vrapo, nëse s'mund të vraposh, ec, nëse nuk ecën, kacavjerru, porsi do që të jetë, vazhdo të ecësh përpara (Martin Luther King)

Mos gjyko ndërgjegjen e njeriut duke shikuar në fytyrën e tij sepse ai mund të ketë zemër të keqe. (William Shakespeare)

Qeshja e zëshme paralajmëron mendjen e zbrazët. (William Shakespeare)

Të falësh, nuk do të thotë të harrosh (Ismail Kadare)

Zgjuarësia është një dritë hyjnore, ndriçimi i sëcilës ndrit jo vetëm sipërfaqen e sendeve, por edhe brendinë e tyre. (Sami Frashëri)

Një shkrimtar duhet gjykuar më shumë nga cilësia se sa nga sasia (Faik Konica)

Ai që i bën vërejtje dikujt se është i edukuar keq, tregon nga ana e tij një edukim të paktën po aq të keq. (Faik Konica)

Kur te jesh i zemeruar, mendja është e turbulluar, bëj durim sa të kullohet, se njeriu pastaj pendohet. (Naim Frashëri)

Pavarësia e Kosovës

Sot është një ditë shumë

e veçantë për çdo shqiptar.
Të kujtojmë ne kohën sa heronjë
atëherë u vranë.

Sa fëmijë atëherë mbetën pa shtëpi
duke pritur babain të kthehej në shtëpi.
Ehh... sa dëshmorë vdiqën për këtë
pavarësi
Që gjithmonë shqiptarët të kenë liri.

Hallall ju qoftë gjaku
që e keni derdh për këtë vatan.
Pa ju trembur syri dolët në mejdan
pa u menduar dy herë armikun e vratë.

Me 17 shkurt u bë pavarësia
u lirua Kosova u lirua Shqipëria.
Heronjtë për Kosovë kanë rreziku veten
dhe
për këtë pavarësi e lanë edhe jetën.

Miku im

Të kam mik
E të kam shok
Je i pari që unë njoh.

Më ke pranë saherë që do
Sikur mik e sikur shok
Gjithmonë kishe një mundësi
Që të rrije tek unë si flori.

Si flori ti më je
Në këto ditë që ti më njeh
Do më kesh afër saherë të duash
Në pikëllimet e gëzimet tua.

Xherdan Shaqiri futbollisti ynë i njohur në botë

Xherdan Shaqiri lindur më 10 tetor 1991 në Gjilan të Kosovës nga prindër shqiptarë nga Kosova. Ai emigroi në Zvicër në vitin 1992 me prindërit e tij dhe me tre vëllezërit dhe motrat e tij. Ata u vendosën në Augst, një qytet i vogël në kontin Basel-Country, afër kufinjëve francez dhe gjerman. Babai i tij nuk fliste dot gjerman ishte zvicëranë, kështu që ai filloi të lante pjata në një restorant, para se të punonte si ndërtues rrugësh. Mamaja e tij punonte si pastruese në zyra ndërtesash në qytet, duke u ndihmuar nga Xherdani dhe vëllezërit e tij. Babai i tij dërgonte para në Kosovë sa të kishte mundësi, gjë që do të thoshte se Xherdani dhe familja e tij nuk kishin para shtesë për të shpenzuar, përveç në rastet e ditëlindjeve. Ai adhuronte sulmuesin brazilian Ronaldo, duke thënë se loja e tij ishte si "magji" Shaqiri filloi karrierën e tij si profesionist te FC Basel, duke debutuar me ekipin e parë në vitin 2009. Pasi fitoi tre kampionate zvicëranë rresht, ai kaloi te klubi gjerman Bayern München. Edhe pse nuk pati ndonjë sukses individual të madh, Shaqiri fitoi edhe tetë trofe të tjerë, përfshirë edhe Ligën e Kampioneve, në sezonin 2012–13, ku ekipi komplettoi tripletën. Në janar 2015, ai u transferua te Interi për 15 milion €, dhe shtatë muaj më pas, kaloi në Premier League te Stoke City. Pasi ekipi ra nga kategoria në përfundim të sezonit 2017–18, Shaqiri firmosi me Liverpoolin për 13.5 milion £.



Xherdan Shaqiri është futbollist profesionist zvicëran i cili luan si mesfushor për klubin anglez Liverpool dhe Kombëtaren Zvicëranë. Shaqiri është mysliman. Ai u zgjodh të ishte në kopertinën e video lojës FIFA 15 në Zvicër sëbashku me yllin global Lionel Messi. Shaqiri sponsorizohet nga kompania e veshjeve dhe pajisjeve sportive Nike. Ai vesh këpucët Nike Mercurial Vapor, dhe gjatë Kupës së Botës 2018, në këpucët e tij ishin të stampuara famujtë e Zvicrës dhe Kosovës. Xherdan Shaqiri është një ndër futbollistët më të mirë shqiptar, të gjithë shqiptarët anë e mbanë botës e mbështesim këtë super futbollist që e përmendën kombin tonë në Zvicër, Gjermani, Angli dhe shumë vende tjera nëpër botë. Xherdan Shaqiri është i rëndësishëm për popullin shqiptar edhe pse nuk ka qëndruar shumë në vendlindjen e tij në Gjilan të Kosovës por ai e mbështet shumë kombin e vet, ashtu siç e mbështet kombi i vet atë. Është futbollisti im i preferuar, dhe shumë do kasha dashur që edhe unë ndonjëherë të bëhem si Xherdan Shaqiri të arrij aty ku është ai, ta kem vlerësimin e tij që e ka në shumë vende nëpër Evropë.


Kryeredaktor
Elma Bexheti

Menaxhimi
Fadlan Kadrija
Mirjeta Durmishi
Donart Ismaili

Një falënderim të vacant deri te profesoreshat që ndihmuan në përgatitjen dhe realizimin e revistës:
Zira Agushi
Asibe N. Salihi
Fatmire Elmazi

Disa nga aktivitetet dhe projektet e zhvilluara në shkollën tonë gjatë muajit shkurt

Nxënësjat jonë Anida Jahji ka pranuar ftesë nga reprezentacioni U 19 i futbollit të vajzave.
Suksese! 🏆🏆🏆



Eshte koha e duhur per qene te shendetshem, ndaj zgjidh ylberin...




KOHA PËR LAJME SHUMICA E NXËNËSVE NË TETOVË VAZHDOJNË TË NDJEKIN MËSIMIN ONLINE



YOUTUBE.COM

SHUMICA E NXËNËSVE NË TETOVË VAZHDOJNË TË NDJEKIN MËSIMIN ONLINE - TV KOHA



HAJE 'YLBERIN'				FUNKSIONI	
Qendra e Kulturës	Ministria e Kulturës	Lidhjet e Kulturës	Parashikimi dhe Organizimi	Shërbimi i Klientit	Shërbimi i Klientit
Koncerte dhe Performanca	Projekte dhe Iniciativa	Shërbimi i Klientit	Shërbimi i Klientit	Shërbimi i Klientit	Shërbimi i Klientit



KOHA PËR LAJME MIRJETA ILAZI Drejtoreshë e Shkollës



KOHA PËR LAJME SHUMICA E NXËNËSVE NË TETOVË VAZHDOJNË TË NDJEKIN MËSIMIN ONLINE

